

**Akt Themelimi**  
**i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar "SPLENDID CONSTRUCTION"**

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë , në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 , " Për shoqëritë tregtare" dhe në Ligjin Nr.9723 , datë 03.05.2007 "Për Q.K.R" dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqërite Tregtare , me vullnetin e tyre të lirë , të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, sot më datë 04.12.2023 me ortakët :

**1. Arten Nelaj i pajisur me ID Nr J60208098E**

krijojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "SPLENDID CONSTRUCTION" me akt themelimi si vijon:

**Neni 1**

Formimi i shoqërisë

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur "SPLENDID CONSTRUCTION". Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit shqiptar , ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues .

**Neni 2**

Selia e shoqërisë

- Selia e shoqërisë "SPLENDID CONSTRUCTION" do të jetë: Vlore Orikum Radhime, Rruga Sazani , Objekt Nr. 39426 e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: **arten.nelaj@yahoo.com**.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve.

**Neni 3**

Objektivi i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë veprimtaritë si vijojnë:

- Punime në fushën e ndertimit. Zhvillimi dhe kryerja e aktivitetit të shërbimeve të ndryshme, hotelerisë, restoranteve, aktivitetit turistik, transportues, menaxhimit, konsulencës dhe studimeve të të gjitha llojeve.

**Neni 4**

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar . Ajo mund shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkaku.

**Neni 5**

Kapitali i shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë private "SPLENDID CONSTRUCTION" do të jetë 100 (njqind ) Lek dhe është i ndarë në aksione në përputhje me ligjin.

1. Ortaku themelues ARTEN NELAJ: Zotërues i një kuote të vetme që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**Neni 6**

#### Drejtimi i shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga administratori **Z. ARTEN NELAJ**. Ai është përfaqësuesi i shoqërisë në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj .

Cdo kontrate do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posacme .

#### Neni 7

Ortakët themelues kanë të drejte të emërojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale, kanë të drejtë të caktojnë financiarë dhe likuidatorë për problemet e shoqërisë.

#### Neni 8

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë .

#### Neni 9

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme , me tekstin rreth saj .

#### Neni 10

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërive Tregtare” , si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombetare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

#### Neni 11

Akti i themelimit u përpilua në 2 kopje , për t’ju shperndare organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë Ortaku i “**SPLENDID CONSTRUCTION**”.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm .

Ortaku i “**SPLENDID CONSTRUCTION**”

**ARTEN NELAJ**

